



Çdo fëmijë në shkollë

Korrik 2018

Shqipëri

PAKETË INFORMUESE PËR PRINDËRIT DHE PËR ANËTARË TË NDRYSHËM NË KOMUNITET



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development
and Cooperation SDC



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISE



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE



United Nations Country Office
"Skenderbej" Street, Gurten Building, 2nd Floor, Tirana, Albania
Tel.: +355 (4) 2250 205, 2250 224, 2250 234

Të dashur prindër,

Fëmija juaj po rritet dhe vjen një ditë që ai mbush moshën e detyrimit shkollor. Hyrja në shkollë është një hap i madh në jetën e fëmijës dhe përbën një ndër çastet më të lumtura që përjeton prindi. Pavarësisht nëse ka ndjekur apo jo kopshtin, fëmija ndien emocion të veçantë kur hyn në dyert e shkollës. Ndaj ju dhe stafi i shkollës duhet të ndikoni pozitivisht në qëndrimin që fëmija ka ndaj shkollës. Hapi i parë shumë i rëndësishëm është familjarizimi i fëmijës me mjedisin dhe me kërkesat e shkollës, sidomos kur ai nuk ka frekuentuar fare kopshtin.

Ju si prindër duhet të punoni që fëmija të përshtatet sa më shpejt me shkollën dhe t'i zvogëloni atij ankthin që mund të ketë ditët dhe javët e para të mësimin. Fillimi i mbarë, gjysma e punës! Një fillim i mbarë është premtues për suksesin e mëtejshëm të fëmijës. Kjo vlen dhe për fëmijën me aftësi të kufizuara, hyrja në shkollë e të cilit është edhe më e ndërlikuar, për arsyet e shumta që prindi i di më mirë se çdokush tjetër.

Ju dhe fëmija juaj diskutoni prej kohësh dhe përgatiteni për hyrjen në shkollë të 6-vjeçarit. Me merakun tuaj jetojnë dhe të afërmit. Si për çdo ngjarje të veçantë, ju duhet të dini se çfarë duhet të bëni para se fëmija juaj të shkojë në shkollë. Kjo paketë informuese ju ndihmon të gjeni përgjigje për shumë pyetje që mund të keni lidhur me përgatitjet për hyrjen në shkollë të fëmijës suaj, por dhe për mbarëvajtjen e tij në mësim. Informacionet dhe udhëzimet që do të gjeni këtu, ju lehtësojnë përgatitjet që duhet të bëni dhe ju kursejnë kohën duke ju ndihmuar në çdo hap, duke filluar me zgjedhjen e shkollës për fëmijën e me regjistrimin e tij në shkollë deri te bashkëpunimi që duhet të keni me stafin e shkollës që fëmija juaj të frekuentojë rregullisht mësimet e të arrijë rezultatet e pritshme dhe suksesin e dëshiruar.

Suksese në udhën e ndryshimit të fëmijës suaj!



E drejta e fëmijëve për arsimim

Në Shqipëri, shkolla publike është falas dhe arsimimi është i detyruar për vajzat dhe djemtë nga mosha 6 deri 16 vjeç.

Një nxënës mund ta vijojë arsimin e detyruar deri në moshën 17 vjeç, me qëllim që të mbarojë klasën që është duke vazhduar.

Të shkuarit në shkollë është një e drejtë ligjore për të gjithë fëmijët shqiptarë dhe të huaj që jetojnë në Shqipëri. Shkolla respekton fëmijët dhe u mëson atyre vlerat e Republikës së Shqipërisë. Djemtë dhe vajzat mësojnë në të njëjtat klasa dhe trajtohen në mënyrë të barabartë.

Shkolla publike është laike: ajo respekton kulturat, gjuhët dhe fenë e secilit. Asnjë fëmije ose të rrituri nuk i lejohet, në asnjë mënyrë dhe formë, të promovojnë në shkollë bindjet e tij fetare dhe/ose opinionet e tij politike.

Në shkollë, fëmija juaj mëson gjuhën shqipe, sepse shqipja është gjuha zyrtare e Republikës. Megjithatë, për fëmijën është e rëndësishme që ai të vazhdojë të përdorë edhe gjuhën e tij të origjinës. Shkolla publike ia mundëson këtë çdo fëmije që i përket një pakice kombëtare. Në shkollë, fëmijët mësojnë të jetojnë së bashku, njihen më mirë me njëri-tjetrin dhe shkëmbejnë kulturat e tyre. Frekuentimi i rregullt i mësimëve është absolutisht thelbësor për fëmijën tuaj që ai të arrijë suksese në shkollë, të përmbushë formimin e tij, të ndërtojë karrierën për të ardhmen dhe të jetë i suksesshëm në jetë.

Prandaj është e rëndësishme të garantojmë që fëmijët të regjistrohen në shkollë dhe t'i mbështesim fort ata që të përfundojnë të paktën klasën e 9-të, dhe jo vetëm, me synim vazhdimin e arsimimit të mëtejshëm të tyre.



Hulumtimet tregojnë se kujdesi i komunitetit, i shoqërisë, por edhe familjes për regjistrimin në shkollë të individit, mund të ndikojë te fëmija që ai të arrijë të përfundojë cilësisht arsimin bazë, dhe jo vetëm kaq. Niveli arsimor i njerëzve ndikon në:

- Forcimin ekonomik të vetë individëve, të familjeve së tyre dhe të shoqërisë.
- Gjendjen shëndetësore të individëve dhe të familjeve, duke përfshirë edhe fëmijët e tyre.
- Barazinë më të madhe gjinore.
- Kujdesin shoqëror dhe sigurinë më të madhe në komunitetet (shkallë më të ulët të kriminalitetit etj.).
- Uljen e barrës së buxhetit për mirëqenien dhe kujdesin si rezultat i treguesve të mësipërm.



Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë legjitimon se *“të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Askush nuk mund të diskriminohet... nëse nuk ekziston një përlligjje e arsyeshme dhe objektive”* (neni 18); *“Kushdo ka të drejtën për arsimim... Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas”* (neni 57).

Në ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, sanksionohet:

- 1. *Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja, ekonomike apo sociale, mosha, vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.*
- 2. *Në shkollat publike arsimi i detyrueshëm dhe arsimi i mesëm i lartë janë falas”* (neni 5). *“Format e arsimimit në shkolla janë: a) arsimim me kohë të plotë; b) arsimim me kohë të pjesshme; c) arsimim në distancë.”* (neni 16).

Në të njëjtin ligj theksohet se

- 1. *Në veprimtaritë e institucioneve të sistemit arsimor parauniversitar, interesi i nxënësit është parësor.*
- 2. *Në sistemin arsimor parauniversitar respektohen, mbrohen dhe promovohen të drejtat e liritë e njeriut në përgjithësi dhe të drejtat e fëmijëve në veçanti.*
- 3. *Në sistemin arsimor parauniversitar, nxënësve dhe punonjësve u ofrohet mbrojtje nga çdo formë veprimi ose mosveprimi që mund t'u shkaktojë diskriminim, dhunë, keqtrajtim ose dëm moral.*
- 4. *Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.*
- 5. *Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.*
- 6. *Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.”* (neni 6)



Gjithashtu, ligji për sistemin arsimor parauniversitar parashikon që

- 1. *Nxënësi ka të drejtë:*
 - *a) të përzgjedhë një institucion arsimor, publik ose privat;*
 - *b) të ndjekë institucionin arsimor publik që është në zonën e përcaktuar nga njëria bazë përkatëse e qeverisjes vendore;*
 - *c) t'i sigurohet nga institucioni shërbim arsimor cilësor, sipas interesave, nevojave dhe mundësive të tij, si dhe ndihmë e posaçme për të përballuar vështirësitë e tij të veçanta të të nxënit...” (neni 61); dhe sanksionon që “Mosregjistrimi dhe mungesat e paarsyeshme të fëmijës në mësim për më shumë se 25 për qind të orëve mësimore gjatë një viti shkollor vlerësohen si rast i neglizhencës prindërore dhe trajtohen siç u përmend, në përputhje me ligjin nr. 10 347, datë 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, i ndryshuar (neni 57).*

Ndërsa sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës:

- 1. *Fëmija mbrohet nga shfrytëzimi ekonomik, sipas parashikimeve të Kodit Penal, që përfshin kryerjen e çdo pune që:*
 - *a) paraqet rreziqe për shëndetin fizik dhe mendor, mirëqenien e zhvillimin e tij tërësor;*
 - *b) cenon edukimin;*
 - *c) është e detyruar.*
- 2. *Ndalohet marrja në punë e fëmijës nën moshën 16 vjeç. Fëmija mund të kryejë punë të lehta, që nuk dëmtojnë shëndetin, formimin e tij ose e largojnë atë nga shkolla, sipas përcaktimeve të parashikuara në Kodin e Punës.” (neni 24)*

RËNDËSIA E REGJISTRIMIT TË FËMIJËVE NË SHKOLLË DHE NDJEKJA NË MËNYRË RIGOROZE E SHKOLLËS



Kush është përgjegjës për regjistrimin e fëmijës në shkollë dhe për arsimimin e tij?

Në ligjin nr. 18/2017, datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” përcaktohet përgjegjësia e organeve vendore dhe e institucioneve arsimore për arsimimin e fëmijëve:

- *“4. Organet e vetëqeverisjes vendore, ministria përgjegjëse për arsimin dhe institucionet përgjegjëse në varësi të tyre marrin masat e nevojshme për të ndihmuar prindin ose kujdestarin të ushtrojë këtë të drejtë, në rast se ka nevojë për asistencë materiale ose programe mbështetëse.” (neni 20).*
- *3.a: Të mundësojnë aksesin e fëmijës në arsimin parashkollor, si dhe arsimin e detyrueshëm falas për të gjithë fëmijët, edhe në rastet kur fëmijët mund të kenë kaluar moshën për arsimin e detyrueshëm, por kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë (neni 18);*
- *3.h: Të marrin masa për identifikimin e fëmijës në rrezik për të braktisur shkollën ose të atij që e ka braktisur atë, duke koordinuar veprimet me autoritetet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, me qëllim mbajtjen ose kthimin e tij në shkollë. (neni 18).*
- *5: Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimi i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë. (neni 24).*

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore dhe njësitë arsimore vendore

Në ligjin për arsimin parauniversitar theksohet se “3. Njësia bazë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me njësinë përkatëse arsimore vendore dhe institucionet arsimore publike, është përgjegjëse për regjistrimin e nxënësve në shkollat publike të arsimit të detyrueshëm me kohë të plotë. 4. Njësia bazë e qeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e njësive arsimore vendore dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kritereve të miratuara në këshillat e njësive vendore, mbështet: a) nxënësit e familjeve në nevojë; b) nxënësit me arritje të shkëlqyera; c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore” (neni 28).

2. Drejtori i shkollës dhe mësuesit

Sipas Dispozitave Normative për sistemin arsimor parauniversitar (2013), të ndryshuara, drejtori i shkollës publike të arsimit bazë me kohë të plotë bashkëpunon me njësinë vendore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës, me këshillin e prindërve të shkollës dhe atë të klasës, me qeverinë e nxënësve dhe me bordin e shkollës për të siguruar ndjekjen e shkollës nga nxënësit (neni 59, pika 1), ndërsa mësuesi kujdestar përkujdeset posaçërisht për ndjekjen e shkollës nga nxënësit (neni 84, pika 3.c).

3. Njësia e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve

Në Dispozitat Normative theksohet që drejtori i shkollës duhet të bashkëpunojë me të gjitha strukturat për mbrojtjen fëmijëve si dhe me strukturat brenda shkollës për të regjistruar fëmijët në shkollë. Gjithashtu, ai duhet të informojë NjMF-në për fëmijët që e braktisin shkollën.



Cilat janë sanksionet për mosfrekuentimin e shkollës nga fëmija?

Sipas Dispozitave Normative, drejtori i shkollës së arsimit bazë njofton me shkresë titullarin e DAR/ ZA-së për nxënësin, që i përket shkollës së tij dhe nuk është regjistruar në shkollë, ose për nxënësin që mungon pa arsye më shumë se 25 përqind të orëve mësimore gjatë një viti shkollor. Titullari i DAR/ZA-së njofton me shkresë bashkinë ku nxënësi banon, me të dhënat e paraqitura nga drejtori i shkollës. Bashkia përkatëse përcakton dënimin me gjobë të prindërve, në përputhje me ligjin nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe procedon më tej sipas legjislacionit në fuqi (neni 88, pika 8).

Çfarë është neglizhimi i fëmijës?

“Neglizhimi i fëmijës” është mosveprimi me ose pa dashje nga ana e një personi, i cili është përgjegjës për rritjen, përkujdesjen apo edukimin e fëmijës, si pasojë e të cilit rrezikohet jeta, integriteti fizik e mendor dhe zhvillimi i fëmijës. (pika 10 e nenit 3 të ligjit “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”).

Po në ligjin nr. 18/2017, datë 23.02.2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës” sanksionohet që, “5. Në rast se një fëmijë, brenda moshës për të cilën parashikohet arsimi i detyrueshëm, shmang arsimimin, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të ndaluara, sipas ligjit, personeli arsimor njofton menjëherë prindin ose kujdestarin, si dhe njësinë e mbrojtjes së fëmijës, të cilët marrin masa të menjëhershme që fëmija të rikthehet në shkollë.” (neni 24), “1. Shkeljet e të drejtave të parashikuara në nenet 8, 9, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 21, 23, 24, 25, 26, 27, 29, 32 e 33, të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë, përkatësisht: a) personi fizik, nga 40 000 deri në 80 000 lekë; b) personi juridik, nga 60 000 deri në 100 000 lekë; c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkeljen, nga 40 000 deri në 80 000 lekë; ç) personi, i cili ushtron funksion publik, nga 60 000 deri në 80 000 lekë” (neni 69).

INFORMACION PËR PRINDËRIT E FËMIJËVE

Sipas ligjit për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës, “1. Fëmija ka të drejtën e aksesit dhe të frekuentimit të arsimit falas e cilësor, në bazë të mundësive të barabarta dhe pa diskriminim, në përputhje me moshën dhe aftësinë e tij për të kuptuar. Kjo e drejtë i garantohet edhe fëmijës që dëshiron të vazhdojë të arsimohet pas përfundimit të arsimit të detyrueshëm. 2. Prindi ose kujdestari merr masa të përshtatshme që fëmija të ndjekë arsimin e detyrueshëm ose nivele të tjera të arsimit, sipas dëshirës së fëmijës, si dhe të garantojë frekuentimin e rregullt të tij dhe pa pengesa.” (neni 18)

Prindër, çfarë përgatitjesh duhet të bëni për regjistrimin e fëmijës në shkollë?

1. Vendosni se në cilën shkollë do ta regjistroni fëmijën tuaj.

Kur zgjidhni shkollën, merrni parasysh nevojat e fëmijës suaj dhe mbështetjen që është në gjendje të ofrojë shkolla. Mos u ndikoni nga opinionet e ndryshme, si: “X shkollë është e mirë”, “X mësuese është e mirë”. Nuk ka shkolla dhe mësuese të mira, por ka shkolla dhe mësuese që punojnë dhe janë të suksesshme. Si rregull, fëmija regjistrohet në shkollën publike që është në zonën e përcaktuar nga njësia bazë përkatëse e vetëqeverisjes vendore, por ai ka të drejtë të përzgjedhë një institucion arsimor, publik ose privat. Ju si prindër duhet t’i paraprini regjistrimit të fëmijës në shkollë. Për këtë:

- a) Informohuni për kushtet dhe shërbimet që ofron shkolla.
- b) Vizitoni bashkë me fëmijën shkollën: njihuni me mjediset e shkollës, me klasën ku do të mësojë fëmija juaj dhe me mësuesin kujdestar.

2. Siguroni dokumentet që kërkohen për regjistrimin e fëmijës në shkollë.

Regjistrimi i fëmijës në klasën e parë bëhet me këto dokumente:

- a) Vërtetimi i vaksinimeve nga qendra shëndetësore.
- b) Vërtetimi i ndjekjes së kopshtit sipas grupeve, i firmosur nga drejtoresha e kopshtit (nëse ka).

Në raste të veçanta, kur prindi dëshiron të regjistrojë fëmijën në klasën e parë, por nuk disponon vërtetimin e vaksinimeve, ai duhet t’i drejtohet qendrës shëndetësore përkatëse dhe, pas marrjes së vërtetimit, shkon në shkollë për të regjistruar fëmijën.

PROCESI I REGJISTRIMIT TË FËMIJËS NË SHKOLLË

Regjistroni fëmijën në shkollë në afatet e përcaktuara.

Sipas Dispozitave Normative, regjistrimi i nxënësve në klasën e parë të shkollave publike bëhet në dy javët e fundit të muajit qershor:

- a) Në gjashtë ditët e para kanë të drejtë të regjistrohen në klasën e parë të një shkolle publike vetëm nxënësit që i përkasin zonës së shkollës. Kur largësia e banesës së fëmijës nga dy shkolla publike është e diskutueshme, prindi zgjedh njërën nga të dyja shkollat.
- b) Në katër ditët pasuese kanë të drejtë të regjistrohen edhe nxënës që u përkasin shkollave të zonave të tjera.
- c) Regjistrime të veçanta pranohen deri ditën para fillimit të vitit shkollor.

Prindër, ju jeni partneri kryesor i shkollës në mbarëvajtjen e fëmijës dhe të institucionit

Sipas Kodit të Familjes, *“Prindërit kanë detyrë dhe të drejtë të kujdesen për mirërritjen, zhvillimin, mirëqenien, edukimin dhe arsimimin e fëmijëve të lindur nga martesë ose jashtë martesë.”* (neni 3). *“Përgjegjësia prindërore përfshin tërësinë e të drejtave dhe detyrave që kanë për qëllim të sigurojnë mirëqenien emocionale, sociale dhe materiale të fëmijës, duke u kujdesur për të, duke mbajtur raporte vetjake me të, duke i siguruar atij mirërritjen, edukimin, arsimimin, përfaqësimin ligjor dhe administrimin e pasurive të tij.”* (neni 215)

Kodi i Familjes parashikon edhe heqjen e përgjegjësisë prindërore: *“Kur prindi shpërdoron përgjegjësinë prindërore ose tregon pakujdesi të rëndë në ushtrimin e saj, ose me veprimet e tij ndikon në mënyrë të dëmshme në edukimin e fëmijëve, me kërkesën e prindit tjetër, të të afërmve të fëmijës ose të prokurorit, mund t’i hiqet përgjegjësia prindërore.”* (neni 228)


Në ligjin nr. 69/2012, datë 21.06.2012 *“Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar, theksohet se *prindi ka detyrë të kujdeset që fëmija i tij të ndjekë rregullisht institucionin arsimor dhe të mësojë rregullisht* (neni 62, pika 3.a).

Në shkollë, fëmija juaj mëson si të jetë sa më i pavarur në punën e tij. Ju mund ta ndihmoni fëmijën të bëhet i pavarur: shikoni dhe kontrolloni nëse fëmija juaj ka bërë detyrat për ditën e nesërme dhe për ditët në vijim.

Prindër, çfarë duhet të bëni që të luani rolin tuaj dhe të përmbushni përgjegjësitë ndaj fëmijës dhe shkollës?



1. Takohuni me drejtuesit dhe me stafin e shkollës para fillimit të mësimave.
2. Informoni në mënyrë të detajuar mësuesin kujdestar për veçantitë e fëmijës suaj.
3. Siguroni informacion të mjaftueshëm për kushtet e sigurisë në shkollë, për mundësitë dhe shërbimet që ofron shkolla.
4. Sigurohuni që fëmijës suaj do t'i ofrohet shërbim arsimor cilësor:
 - a) A do të arsimohet në mënyrë të barabartë fëmija juaj, në të njëjtat kushte si fëmijët e tjerë?
 - b) A ka mësuesi i kujdestar përvoja pune me fëmijë të ngjashëm me veçantitë e fëmijës suaj?
 - c) A ka shkolla staf mbështetës (psikologë, punonjës socialë, infermier apo mjek) me përvojë në punën me fëmijët?
 - d) A ka në shkollë mësues ndihmës apo mësues të specializuar për aftësinë e kufizuar?
 - e) Në ç'formë do të informoheni për mbarëvajtjen e fëmijës suaj në shkollë?
 - f) A punon shkolla me plane edukative individuale për nxënësit me aftësi të kufizuar dhe ata me vështirësi në të nxënë? Një plan i arritjeve personale mund të hartohet dhe të zbatohet nga stafi i shkollës me pëlqimin tuaj dhe në bashkëpunim me ju dhe me fëmijën tuaj. Informohuni nga komisioni i shkollës në lidhje me mbarëvajtjen, arritjet akademike dhe sociale të fëmijës suaj, sipas planit edukativ individual të hartuar për të.

- 
5. Nëse fëmija juaj ka aftësi të kufizuar ose nevoja të veçanta:
 - a) zgjidhni një shkollë të zakonshme publike për edukimin më të mirë të mundshëm të fëmijës suaj;
 - b) informoni drejtuesin e shkollës për nevojat e fëmijës;
 - c) njihuni me kushtet dhe aksesin që ofron shkolla për fëmijën me aftësi të kufizuar (lartësia e shkallëve, rampa dhe përshtatshmëria e saj, mjediset e përshtatura për ndërveprim: oborri, korridoret, klasat, tualetet, kabinetet e laboratorët, mjetet mësimore sipas lëndëve, biblioteka, palestra etj.);
 - d) kërkoni që fëmija juaj të regjistrohet në të njëjtën klasë me bashkëmoshatarët e tij;
 - e) kërkoni informacion nga drejtori i shkollës për mënyrat se si shkolla do të përmbushë nevojat e fëmijës suaj;
 - f) Identifikoni nevojën e fëmijës për mbështetje dhe sqaroni rolet dhe përgjegjësitë e palëve;
 - g) kërkoni që arsimimi synon zhvillimin e plotë të potencialit intelektual e fizik dhe përmirësimin e cilësisë së jetës së fëmijës për ta përgatitur për integrim të plotë në shoqëri dhe në tregun e punës.
 6. Kërkoni t'ju krijohet mundësia që ju si prind të vizitoni klasën gjatë procesit mësimor.
 7. Kërkoni që shkolla të mbështesë dhuntitë e fëmijës suaj dhe ta përfshijë atë në veprimtaritë e ndryshme që organizon klasa/shkolla.
 8. Kërkoni të merrni pjesë në veprimtari që klasa dhe shkolla organizojnë jashtë procesit mësimor.
 9. Tregohuni të gatshëm të jepni ndihmesën tuaj për mbarëvajtjen e procesit mësimor- edukativ në shkollë.
 10. Ushtroni të drejtën për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur në këshillin e prindërve të klasës, në këshillin e prindërve të shkollës dhe në bordin e institucionit arsimor.
 11. Tregoni interes të vazhdueshëm për punën e fëmijës në shkollë. Bisedoni me të. Kur fëmija kthehet në shtëpi pas shkolle, pyeteni atë se çfarë bëri gjatë ditës dhe çfarë mësoi. Mos hezitoni të takoni drejtorin apo mësuesin kujdestar, nëse fëmija juaj ka ndonjë shqetësim.

Për çdo paqartësi, drejtoheni në drejtorinë e shkollës. Nëse mbeteni ende të paqartë, drejtoheni në njësinë për mbrojtjen e fëmijëve dhe në njësinë arsimore vendore.

Përgatiti: Dr. Besnik RAMA, ekspert arsimi